



Dy bodigardë përjashtuan nga konferenca për shtyp e Partisë Socialiste gazetarin e [Radio](#)

[Televizionit Shtetëror Qeveritar DigiSAL](#)  
të  
[Këshillit të Ministrave.org](#)

Sipas bodigardëve, gazetari i DigiSAL po harxhonte kohën kot pasi në konferencë mjaftonte prania e gazetarit të Tv Klan i cili mund tja pasonte kronikën atyre të TVSH dhe anasjelltas.

Por gazetari me vetmohim nuk lëshonte istikamin e tij dhe hyri në një grevë journalistike 5 sekondëshe duke rrezikuar të binte dëshmor në ditën e dëshmorëve.

Zëdhënsja e [Këshillit të Ministrave.org](#) Erla Mhilli ka dalë në një konferencë për të gjitha madiat dhe ka lexuar një notë proteste të ashpër për këtë mynxyrë, për këtë atentat ndaj lirisë së medias qeveritare shtetërore. {japopup type="youtube" content="http://www.youtube.com/v/vjS\_pzUI\_TU" width="640" height="380"} [VIDEO] {japopup type="youtube" content="http://www.youtube.com/v/vjS\_pzUI\_TU" width="640" height="380"}{/japopup} Zëdhënsja e Qeverisë sqaroi se [DigiSAL](#)

paguhet me taksat e admiruesve të qeverisë të cilët shohin cdo ditë mësuesin e lavdishëm, liderrin e paharrueshëm që thyen rekordet e notit, ngjitjet e mureve kineze, blerjen e [kompjuterit hi-tech iSAL](#), dhe qindra mijëra gëzime personale të kryeministrit të cilat shfaqen në ekranin e Televizionit Shtetëror Qeveritar.

Si mundet PS të hedhë poshtë vlerat e [Televizionit Qeveritar DigiSAL](#) ku shqiptarët kanë parë sesi kryeministri italian [Berlusconi lëshonte komplimenta për bukurinë e femrave shqiptare](#), ose për kryeministri Berisha kur u bë [Qytetar Nderi i Kamzës](#)

, kur dëmshpërblente banorët e

[zonave të përmbytura të Shkodrës](#)

apo kur gjatë udhëtimit historik siamez në Bruksel gjeti kohën të takonte mikun e tij dhe të të gjithë shqiptarëve,

[Fatos Nanon](#)

[Këshilli i Ministrave.org](#) kërkon nga drejtues të PS të mos pengojnë praninë e mediokërve, më falni mediave qeveritare në aktivitetet e opozitës.